

RAPORTI I AUDITIT TË PAVARUR

PËR AUDITIMIN E FONDEVE TË PËRFITUARA DHE TË SHPENZUARA

PER VITIN KALENDARIK 2017

“PARTIA REPUBLIKANE SHQIPTARE”

Tabela e përmbajtjes

- 1-Raporti i Auditusit te pavarur.**
- 2-Pozicioni Financiar**
- 3-Pasqyra e Aktiviteteve**
- 4-Pasqyra e fluksit te parase**
- 5-Shenime per pasqyrat financiare**

Tirane me 25 qershor 2018

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Partisë Republikane Shqiptare "

Te nderuar Zotërinj ,

Në cilësinë e Ekspertit Kontabël të Regjistruar, bazuar në vendimin Nr.23 datë 27.04.2018 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "Për shpalljen e rezultatit të shorrit për emërimin e eksperteve kontabël të licencuar, të cilët do të kryejnë auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga Partitë Politike për vitin kalendarik 2017", dhe në Kontracën e Shërbimit datë 05.06.2018 të lidhur me KQZ, kam kryer auditimin e pasqyrave financiare për fondet e përfituara dhe të shpenzuara nga "Partia Republikane Shqiptare " për vitin kalendarik 2017.

Opinion

Në kemi audituar pasqyrat financiare "Partise Republikane Shqiptare " të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2017, pasqyrën e aktiviteteve dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të *Partise Republikane Shqiptare "* më datën 31 dhjetor 2017, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit të Organizatave Jo Fitimprurëse (SKK për OJF).

Baza për Opinimin

Në e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Partia Republikane Shqiptare në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kodit të Etikës për Kontablistët Profesionistë si dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur edhe përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Në besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK për OJF, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Partise Republikane Shqiptare për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të

vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujtojë Partisë Republikane Shqiptare ose të ndërpresë aktivitetin, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Partisë Republikane Shqiptare .

Përgjegjësia e Audituesit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e niveli të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbulimin e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të njohësive dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë, se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keçinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontroleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe zbulimeve përkatëse të bëra nga Manaxhimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, të zbatuar nga Manaxhimi dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin e auditimit tek informacioni i paraqitur në shënimet shpjeguese të lidhura me pasqyrat financiare ose, nëse informacioni i paraqitur në shënimet shpjeguese është i pamjaftueshëm, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund t'i shkaktojnë Shoqërisë ndërprerjen e vazhdimësisë në përputhje me parimin e vijimësisë.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjet e pasqyrave financiare vjetore, duke përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, si dhe nëse pasqyrat financiare vjetore paraqesin transaksionet dhe ngjarjet kryesore në mënyrë që të arrihet një paraqitje e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Partisë Republikane Shqiptare , përveç çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjatjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo marrësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

Alida Daija (EKR)

Auditues Ligjor

alidadaija@yahoo.com

Rr Ali Pashe Gucia Nr.90

Tirane.



"ALIDA DAIJA"
EKSPERT KONTABIL
REGHISTRAR L16744

Pozicioni Financiar
Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017
(Te gjitha balancat jane ne leke)

PARTIA
REPUBLIKANE SHQIPTARE

Nr	A K T I V E T	Me 31 Dhjetor 2017	Me 31 Dhjetor 2016
I	AKTIVET AFATSHKURTRA		
1	Aktivitet monetare	<u>9,577,499</u>	<u>4,482,275</u>
	> Banka	9,386,693	4,292,832
	> Arka	190,806	189,443
2	Te drejta dhe interes i arketueshem	0	
3	Perapagim taksa te tjera		
4	Inventari		
	TOTALI I AKTIVEVE AFATSHKURTRA	<u>9,577,499</u>	<u>4,482,275</u>
II	AKTIVET AFATGJATA MATERIALE		
1	Toka, Ndertesa, makineri dhe Pajisje		
2	Aktivitet afatgjata te patrupazuara	0	0
4	Totali i Aktive afatgjata materiale (II)	0	0
	TOTALI AKTIVEVE (I+II)	<u>9,577,499</u>	<u>4,482,275</u>
Nr	PASIVET		
I	PASIVET AFATSHKURTRA		
1	Te pagushme ndaj paleve te treta	11,140,000	11,140,000
2	Te pagushme ndaj shtetit	0	
3	Kontribute te marra ne avance		
	Totali i Pasiveve afatshkurtra (I)	<u>11,140,000</u>	<u>11,140,000</u>
II	PASIVET AFATGJATA		
1	Grande	-	-
2	Premtime te kushtezuara per te dhene	-	-
	Totali i Pasiveve afatgjata (II)	-	-
	TOTALI PASIVEVE (I+II)	<u>11,140,000</u>	<u>11,140,000</u>
III	AKTIVET NETO	-1,562,501	-6,657,725



Pasqyra e Aktiviteteve (performances)
Per vitin e mbylltur me 31 dhjetor 2017
(Te gjitha balancat jane ne leke)

PARTIA
REPUBLIKANE SHQIPTARE

	Me 31 Dhjetor 2017	Me 31 Dhjetor 2016
Te ardhurat		
Nr Te ardhura nga tarifat e antaresimit	0	
1 Te ardhura nga grantet qeveritare	12,173,450	6,632,217
2 Te ardhura nga donacione e te tjera		
3 Te ardhura nga investimet apo dhurimet	-	-
4 Te ardhura te tjera		
Totali i te Ardhurave nga aktivet neto te pakufizuara	12,173,450	6,632,217
Shpenzimet per aktivitetet	-	-
Kosto e punes	500,025	1,225,446
Pagat e personelit	359,408	833,496
Shpenzimet per sigurimet shoqerore e shendetesore	130,617	391,950
Amortizimi dhe zhvleresimet	-	-
Shpenzime te tjera operative , komisione ,nafte	6,578,201	6,246,012
Totali i Shpenzimeve	7,078,226	7,471,458
Rritja/renia ne aktivet neto	5,095,224	839,241
Aktivt neto ne fillim te vitit	(6,557,725)	(5,818,484)
Aktivt neto ne fund te vitit	-1,562,501	-6,657,233



Pasqyrat e fluksit te Parase
Per vitin e mbyllur me 31dhjetor 2017
(Te gjitha balancat jane ne leke)

PARTIA REPUBLIKANE
SHQIPTARE

Nr	Me 31 Dhjetor 2017	Me 31 Dhjetor 2016
I Fluksi i parave nga aktivitetet e shfrytëzimit		
Para te arketuara ngakontribute te paku fizuara	12,173,450	6,632,217
Para te arketuara nga perfituesit e sherbimeve		
Grand I pagueshem/kthyeshem		0
Te paguara per punonjesit dhe furnitoret	(7,078,226)	(7,471,458)
Interes I paguar		
Interes dhe dividend te arketuara		
Flukset neto nga aktivitetet e shfrytëzimit	5,095,224	-839,241
II Fluksi parave nga aktivitetet investuese		
Kontribute te kufizuara		
Blerje/shitje investimesh		
Blerje/shitje te aktiviteskatgjata materiale		
Flukset neto nga aktivitetet investuese	0	0
III Fluksi parave nga aktivitetet financiare		
Arketime nga kontributet e kufizuara per investime ne d'aurime	-	-
Interesa dhe dividende te kufizuara per qellime dhe termat atëgjate	-	-
Flukset neto nga aktivitetet financiare		
IV Mjetet monetare ne fund te periudhes		
Rritja/Renia neto e mjeteve monetare	5,095,224	-839,241
Mjetet monetare ne fillim te periudhes kontabel	4,482,275	5,321,516
Mjetet monetare ne fund te periudhes kontabel	9,577,499	4,482,275



1- INFORMACION I PERGJITHSHEM

Partia Republikane Shqiptare, është rregjistruar, pranë Gjykatës së shkalles së parë Tiranë, me urdher Nr. 16/2 datë 10.01.1991 të Ministrisë së Drejtësisë, si një organizatë politike e pavarur e krijuar në komformitet të plotë me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionit në fuqi. Kryetar i saj, është **zoti Fatmir Mediu**.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave të Ligjit nr. 8580, dt. 17.02.2000 "Për Partitë Politike" i ndryshuar, Ligjit nr. 8788, dt. 07.05.2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse", Ligjit 8779, dt. 07.05.2001 "Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse", nga Statuti i saj dhe Legjislacioni në fuqi.

Selia e partisë ndodhet në Tiranë në rrugën "Abdi Toptani" ish hotel Drini kati III të (ndertese shtetërore) .

Partisa Republikane Shqiptare është e rregjistruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë me NIPN :K52428003L

Qëllimi i krijimit: Qëllimi dhe objektivat e Partisë Republikane Shqiptare janë të përcaktuara në aktin e themelimit dhe Statutin e saj.

Organizimi dhe drejtimi

Organet drejtuese të *Partisë Republikane Shqiptare* janë:

- Kongresi i Partisë
- Asambleja Kombëtare
- Kryetari i Partisë
- Kryesia e partisë
- Komiteti drejtues i Partisë

Drejtimi i Partisë bëhet nga Kryesia e Partisë.

Administrimi i saj bëhet nga Kryetari i Partisë.

Burimet financiare të Partisë janë:

- Të ardhurat nga kuotacionet;
- Të ardhurat nga buxheti i shtetit, në përputhje me legjislacionin për financimin e partive politike
- Ndihmat dhe dhurata e anëtarësisë dhe të përkrahësve të Partisë sipas ligjit për partitë politike.
- Çdo e ardhur tjetër që nuk bie në kundërshtim me legjislacionin për financimin e partive politike.

Baza Ligjore për kryerjen e këtij misioni :

- Ligji nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar me ligjin nr.10374 datë 10.02.2011

- Ligji nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe të Kontabilistit të Miratuar",
- Standartet Ndërkombëtare të Auditimit SNA 700;
- Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"
- Çdo dokument ligjor të marrë pranë Partisë.
- Vendimi nr.23 date 27.04.2018 te KQZ.

-SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE

-PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE E RREGULLAVE KRYESORE KONTABËL

Mënyra e Prëgatitjes së Pasqyrave Financiare.

Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet e tyre materiale, në përputhje me Normat Kombëtare të Raportimit Financiar,(SKRF) të cilat përfshijnë rregullat e përcaktuara në ligjin Nr. 9228 datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare,, dhe Planit Unik Kontabel, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave dhe në përputhje me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit të Organizatave Jofitimprurëse (SKK për OJP) ne fuqi nga 1 Janar 2016.

Bazat e matjes.

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

Vijueshmëria

Pasqyrat financiare janë përgatitur sipas parimit të vijueshmërisë. Sipas këtij parimi, Partia parashikon se veprimtaria e saj do të ketë vijimësi në mënyrë të mjaftueshme që të plotësojë objektivat dhe angazhimet dhe se nuk ka në plan ose nuk do të ketë të nevojshme të ndërpresë aktivitetin e saj në një të ardhme të afërt.

Kontabiliteti është ndërtuar mbi bazën e parimeve të konstatimit. Sipas kësaj mënyre, fondet e përfituara në të holla, janë regjistruar në momentin e arkëtimit të tyre dhe fondet e përfituara në natyrë dhe shërbimet në momentin e kryerjes, duke i konvertuar në lekë me çmimin e tregut dhe shpenzimet janë pasqyruar në momentin e konstatimit të tyre kur janë kryer. Kontabiliteti mbahet në mënyrë manuale.

Administrimi i fondeve të përfituara dhe shpenzimet e kryera, janë të përqëndruara, në Selinë e Partisë.

Përmbledhje e politikave kryesore kontabël

Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Pasqyrat financiare të Subjektit janë prezantuar në Lekë shqiptar (Lekë), e cila është monedha funksionale. Te ardhurat (fondet e perfituara) janë perfituar në leke. Shpenzimet janë paguar në leke. Informacioni financiar është paraqitur në Lekë.

Parimet kontabël kryesore të përdorura për përgatitjen e pasqyrave financiare janë si më poshtë:

Njohja e te ardhurave dhe shpenzimeve

Burimet financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 janë njohur mbi bazën e parimit të drejtave të konstatuara, për fondet e siguruara nga buxheti .

Përdorimet e fondeve të njohura në pasqyrat financiare përfshijnë të gjitha pagesat e kryera për vitin 2017, dhe shpenzimet e kryera për vitin 2017, por që nuk janë paguar në fund të vitit.

Tatimi mbi fitimin

Partia Republikane Shqiptare është organizatë jofitimprurës. Si i tillë, Partia nuk paguan tatim mbi fitimin. Ajo respekton dispozitat e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat në Republikën e Shqipërisë" në lidhje me tatimin mbi të ardhurat personale.

Llogaritë e arkëtueshme dhe llogaritë e pagueshme

Llogaritë e arkëtueshme dhe llogaritë e pagueshme në fund të vitit janë paraqitur me koston e tyre historike. Kërkesat për arkëtim janë të pasqyruara mbi bazën e vlerës së faturave origjinale; të lëshuara nga klientët apo të dokumentave të tjerë kontabël. Detyrimet janë njohur dhe pasqyruar mbi bazën e faturave dhe dokumentave origjinale kontabël.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë gjendjen në arkë, llogaritë rrjedhëse në para në banka.

Teprica dhe defiqiti i burimeve

Teprica / defiqiti midis të ardhurave dhe shpenzimeve, që krijohet gjatë vitit, pasqyrohet në **Aktivët neto** (pasurinë neto) të Partisë .

Kontributet për sigurimet dhe Fondi i pensioneve

Partia paguan kontributet për pensione si dhe për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit e saj, siç është parashikuar në legjislacionin shqiptar. Kontributet, bazuar në pagat, janë paguar në llogari të organizmave kombëtare përgjegjëse për pagesën e pensioneve dhe sigurimeve shëndetësore. Nuk ka asnjë detyrim tjetër në lidhje me fondin për pensione dhe sigurimet shëndetësore.

Per te dale ne konkluzione sa me te sakta auditori, ne kuadrin konceptual te te ardhurave dhe shpenzimeve, mori ne konsiderate ngjarje dhe fakte ekonomike financiare qe i takojne gjitha periudhes ushtrimore, 1 janar deri me 31 dhjetor 2017. Auditimi i situates financiare mori per baze gjitha dokumentacionin kontabel te mbajtur dhe raportuar gjate dhe ne fund te vitit 2017, rregjistrat kontabel si dhe gjitha dokumentacionin e nevojshem , gje qe mundesoi dhe krijimin e opinionit te Audituesit te Pavarur .

Mjete monetare

Gjendja e mjeteve monetare më 31 dhjetor 2017 është si më poshtë:

Banka	9.386.693 leke
Arka	190.806 leke
Totali	9.577.499 leke

Gjendjet e llogarive të likuiditeteve të paraqitura në pasqyrat e pozicionit financiar janë të njëjta me të dhënat e llogarive rrjedhëse dhe konfirmohen nga nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventarët fizikë të monedhave. Partia ka tre llogari bankare ne Intesa SanPaolo Bank ne leke.

Detyrimet

Teprica e Detyrimot Afatshkurtera per vitin qe mbyllet me 31 Dhjetor 2017 paraqitet si me poshte:

-Te pagueshme ndaj paleve te treta	11.140.000 leke
Totali	11.140.000 leke

Te pagueshme ndaj paleve te treta perfaqesojne detyrimet ndaj furnitoreve Top Channel-Spot publicitar ne shumen 9.140.000 leke te trasheguara nga viti 2013 dhe Media 6 (Klan)-spot publicitar ne shumen 2.000.000 leke te trasheguara nga viti 2013 te cilat jane te shoqeruara me faturat perkatese.

Te ardhura dhe shpenzime

Te ardhurat dhe shpenzimet evidentohen ne nje rrjet te detajuar llogarish te cilat mundesojne kontrollin dhe marrjen ne kohe te informacionit.

Te Ardhurat

Partia Republikane Shqiptare gjate vitit 2017 ka krijuar te ardhura nga burime te ligjshme si me poshte:

1-Të ardhurat nga buxheti i shtetit, në përputhje me legjislacionin për financimin e partive politike.

Nga auditimi i kryer, në zbatim të nenit 87 të ligjit nr 10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë " rezultoi se për periudhën e kontrolluar subjekti ka përfituar fonde nga buxheti i shtetit në shumën 12.173.450 nga keto:

1.Financim i buxhetit për vitin 2017	10.122.643 leke
2.Financim i buxhetit për fushatën zgjedhore	2.050.791 leke
3. Interes bankar	16 leke

Keto fonde janë evidentuar në bazë të një dokumentacioni të mirëfilltë financiar siç është transaksioni bankar.Partia ka llogari bankare për fondet buxhetore për fushatën zgjedhore.

2-Te ardhura nga kuotat e anetaresimit .

Në zbatim të ligjit nr 8560 datë 17.02.2000 "Për Partitë Politike" anëtarët e partisë derdhen kuota anetaresimi të cilat përdoren për shpenzime nga subjekti politik. Gjatë vitit 2017, Auditimi nuk ka konstatuar të ardhura nga kuotat e anetaresimit.

3-Te ardhura nga donacionet.

Gjatë vitit 2017, Auditimi nuk ka konstatuar të ardhura nga donacionet në para apo në natyrë.Donatoret individë mbi dhe nën 100.000 leke nuk ka.

4-Kredi ,garanci të ndryshme .

Gjatë vitit 2017 Partia nuk ka marrë kredi apo garanci të ndryshme nga banka dhe institucione të tjara financiare,apo të treta.

Te ardhura të realizuara gjatë ushtrimit paraqiten sa më poshtë :

Te ardhurat sipas burimit	Shuma në leke
Buxheti I shtetit për vitin 2017	10,122,643
Buxheti I shtetit për fushatën	2,050,791
Interes bankar	16
Totali	12,173,450
Gjendja në fillim të vitit 2017	4,482,276
Totali	16,655,726
Shuma e shpenzuar gjatë vitit 2017	7,078,226
Gjendje arke banke 31.12.2017	9,577,500

Shpenzimet .

Shpenzimet janë evidentuar dhe deklaruar në përputhje me parimin kontabel të angazhimeve sipas të cilit ato përfshihen të gjitha shpenzimet e kryera dhe të njohura pavarësisht sësë janë apo mbeten për të paguar në periudhat e ardhshme.Konsumi i materialeve, furniturave, punimeve e shërbimeve, të pasqyruara në dokumentat justifikues janë regjistruar me

shumat e paguara ose te pagueshme. Kostoja e personelit, paga dhe sigurimet shoqerore jane pasqyruar saktesisht si shpenzim ne vleren e realizuar dhe te dokumentuar.

Shpenzimet e veprimtarise kryesore

Shpenzimet sipas natyres	Shuma ne leke
shpenzimet per fushaten zgjedhore	2,499,401
Shpenzime te perditeshme per stafin	1,269,421
Shpenzime per pagat e personelit	369,408
Shpenzime per sig shoq dhe shendet	130,617
shpenzime per energji elektrike	61,258
shpenzime per dicta dhe honorare	780,000
shpenzime per karburant	179,700
shpenzime per degjet e PR ne rrethe	1,000,000
Shpenzime telefonike	507,738
Komision bankar	12,000
Blerje paisje	268,683
SHUMA TOTALE	7,078,226

Shpenzime personeli

Teprica e shpenzime personeli per vitin qe mbyllet me 31 Dhjetor 2017 paraqitet si me poshte:

-shpenzime per paga	369.408 leke
-shpenzime per sig shoqerore dhe shendetsore	130.617 lek
Totali	500.025 leke

Shpenzimet per pagat jane llogaritur per dy punonjes per tete muaj.
 Ne shpenzimet per sig shoqerore dhe shendetsore eshte perfshire shpenzimi i dhjetorit te viti 2016 .
 Auditimi i shpenzimeve u realizua ne analize te tyre ne krahasim me dokumentin justifikues te paraqitur nga subjekti.
 Në lërësi, shpenzimet janë të dokumentuara me fatura tatimore , si dhe janë të evidentuara në pajtim me rregullat dhe standartet kontabile që zbatohen në Shqipëri.

Ngjarje te mevonshme.

Nuk ka patur ngjarje te mevonshme qe mund te influencojne ne Pasqyrat financiare te mesiperme.

Te ndryshme

Fondi i financuar nga buxheti i shtetit me shkrese te Ministrise se Financave nr. 8135/1 date 08.06.2017 ne shumen 2.050.791 leke per fushaten zgjedhore te Partise, duhet ti kthyer Buxhetit te Shteti sipas vendimit te KQZ nr.558 me date 31.07.2017 ne shumen 2.050.791 leke.

Alida Daija



"ALIDA DAIJA"
EKSPERT KONTABEL
NR.01570548 L12124

Eksperte Kontabel e Rregjistruar

